

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR



Për *Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*

Rr. Ibrahim Rugova, Nr. 4, Tiranë 1007

I. Informacion i Përgjithshëm

Bazuar në Kontratën nr. Prot. 2336, datë 09/05/2022 lidhur me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) në cilësinë e Ekspertit Kontabël të Liçensuar (Auditues Ligjor) me misionin e auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzimeve për vitin kalendarik 2021 për **Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë**. Si vijon, po ju paraqes raportin e hartuar sipas formatit të standartizuar nga KQZ-ja.

II. Informacion Ligjor

i. *Kuadri Ligjor*

Refruar kontratës së shërbimit, auditimi ligjor i raporteve vjetore financiare të partive politike kërkohet dhe realizohet në zbatim të kërkesave ligjore si vijon:

- Ligji Nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratur", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare";
- Udhezimi Nr. 10, datë 21.04.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për caktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre, dhe mënyrën e pagesës së audituesve".

Nga pikëpamja profesionale kryerja e auditimit ligjor bazohet në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të) të miratuara dhe të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe të Dhënies së Sigurisë të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK), të detyrueshme për zbatim nga ligji për auditimin e sipërcituar.

ii. *Standartet e kontabilitetit të zbatueshme*

Në përputhje me Ligjin, Nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", partitë politike kanë statusin e njëjësive jofitimprurëse dhe janë objekt i Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të) dhe specifikisht i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jofitimprurëse (SKK për OJF-të).

Sipas këtij Ligji, Njësitë ekonomike jofitimprurëse (OJF) hartojnë pasqyrat financiare si më poshtë:

- a) pasqyrën e pozicionit financiar;
- b) pasqyrën e aktiviteteve;
- c) pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare;
- ç) shënimet shpjeguese.

III. Objekti i Auditimit

i. Kontrata e shërbimit

Për përmbushjen e misionit të auditimit, me palën angazhuese KQZ-në, u lidh kontrata e shërbimit Nr. Prot. 2336, datë 09/05/2022, me objekt: "Kryerja e auditimit të detyrueshëm të partive politike, të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë periudhës raportuese 2021, në përputhje me Ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i ndryshuar dhe ligjeve të tjera respektive cituar sa më sipër.

ii. Përgjegjësitë përkatëse të subjektit zgjedhor dhe audituesit ligjor

Përgjegjësitë e drejtimit të Partisë Politike

Auditimi do të kryhet bazuar në faktin që drejtimi (personi përgjegjës për regjistrimin dhe kontrollin e aktivitetit financiar të partisë politike ose personi i përcaktuar sipas statutit të partisë) pranon dhe kupton se ka përgjegjësi:

- a) Për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare (raportit vjetor) në pajtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat Jo-Fitimprurëse (SKK për OJF-të) dhe me kërkesat specifike të ligjit "Për Partitë Politike" i ndryshuar, dhe në udhëzimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-së);
- b) Për kontrollin e brendshme të atilla që drejtimi partisë i konsideron të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale nga mashtrimi apo gabimi; dhe
- c) I'i ofrojë audituesit:
 - Të drejtën e hyrjes në të gjitha informacionet për të cilat drejtimi ka dijeni se janë të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare, sic janë regjistrimet, dokumentacioni dhe çështje të tjera;
 - Informacion shtesë, të cilin audituesi mund ta kërkojë nga drejtimi për qëllime të auditimit; dhe
 - Të drejtën e komunikimit pa kufizim me personat brenda partisë nga të cilët audituesi e gjen të nevojshme për të marrë evidencë auditimi.

Si pjesë përbërëse e procesit të auditimit, do të kërkohen nga drejtimi i partisë dhe, kur të jetë e përshtatshme, edhe nga personat e ngarkuar me administrimin që të merren prej tyre konfirmime me shkrim lidhur me deklaratimet me gojë që do të bëhen në lidhje me auditimin.

Përgjegjësitë e Audituesit

Auditimi do të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Këto standarde kërkojnë që të respektohen kërkesat etike. Si pjesë e një auditimi sipas SNA-ve, do të ushtroj gjykimin profesional dhe do të ruaj skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit.

Objektivat janë që të arrihet një siguri e arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare (raporti vjetor financiar), në tërësi, nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshohet një raport auditimi që përfshin opinionin tim. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet e përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Gjithashtu kam dhe përgjegjësi të tjera raportuese, që burojnë nga termat e kontratës, për të vlerësuar përputhshmërinë e veprimeve ekonomike dhe financiare, që lidhen me kërkesat specifike të Ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për Partitë Politike", i ndryshuar dhe udhëzimet e KQZ-së, me burimet e financimit, procedurat e marrjes së donacioneve jopublike, dokumentimit dhe regjistrimit të tyre, identifikimin e dhuruesve, publikimin e tyre, etj.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve dhe anomalive materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Kur vlerëson këto rreziqe, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit që lidhet me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare për të planifikuar procedura të përshtatshme auditimi për rrethanat përkatëse, por jo me qëllim që të shprehë një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Prandaj, ne nuk shprehim një opinion të tillë. Një auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe të arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të Pasqyrave financiare.

IV. Informacion mbi Subjektin Politik

i. Prezantimi i subjektit politik

Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë është themeluar më 18 Maj 2012, me Nr. Vendimi të Gjykatës 5096, Nr. Regjistri 11691, me veprimtari Parti politike në përputhje me Ligjin nr.8580 datë 17.02.2000 "Per Partitë Politike", i ndryshuar.

Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë ushtron veprimtarinë e saj me seli të regjistruar në adresë: Lagjia "Skenderbeg", Rr. Gjovalin Gjadri, Shkodër.

Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë nuk është e regjistruar në sistemin tatimor me NIPT dhe nuk ka kryer deklarimet e duhura sipas përgjegjësive tatimore dhe aktivitetit që ajo ka kryer.

V. Prezantimi i Raportit Vjetor dhe Struktura e tij

i. Struktura e raportit— kërkesat formale, të ardhurat dhe shpenzimet

Struktura e Raportit vjetor financiar (Pasqyrat financiare) të Partisë Popullore Kristiandemokrate të Shqipërisë, të vëna në dispozicion tonin përbëhen nga Pasqyra e pozicionit financiar, Pasqyra e performancës (fondet e përfituara dhe shpenzuara 2021) dhe Pasqyra e flukseve të parasë si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare.

ii. Takimet dhe komunikimet midis audituesit dhe subjektit zgjedhor dhe çdo personi tjetër të tretë

Menjëherë pas firmosjes së kontratës me KQZ-në janë vendosur kontaktet me personin që merret me administrimin e partisë. Në vijim u ofruan të dhënat financiare për vitin 2021 si dhe informacioni lidhur me aktivitetin e Partisë përgjatë dy viteve të fundit, të cilat janë firmosur nga Kryetari i Bordit të Financave dhe N/kryetari i Partisë.

iii. Paraqitje e përgjithshme e raportit vjetor të partisë politike, përputhshmëria e tij me kërkesat e raportimit

Kam vlerësuar paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e raportit vjetor (pasqyrave financiare), përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna si dhe statusin e Partisë lidhur me mungesën e regjistrimit të saj në organet tatimore.

VI. Opinioni

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë nuk është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat e opinionit tonë të auditimit.

i. Bazat e refuzimit për të dhënë Opinion

1. Pavarësisht kontaktit të siguar me subjektin politik dhe Pasqyrave financiare të përgatitura për vitin 2021 të vëna në dispozicion, rezulton që subjekti politik nuk ka kryer asnjë aktivitet, nuk ka përfituar fonde dhe kryer shpenzime përgjatë vitit raportues 2021 dhe vitit të mëparshëm 2020. Asnjë dokumentacion tjetër vërtetues përkatës mbi bazën e të cilit janë përgatitur këto pasqyra, si dhe informacione të tjera, që të mundësonte auditimin tonë sipas kërkesave të SNA-ve dhe Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar me Ligjin 74/2012) nuk janë vënë në dispozicion.
2. Duke qenë të informuar nga vetë subjekti politik, Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë nuk është regjistruar në organet e tatimeve, si detyrim i kërkuar nga neni 40, pika 4/4.1.a dhe neni 42, i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar) dhe nuk ka dorëzuar pasqyrat financiare të vitit fiskal që përfundon më 31.12.2021 sipas kërkesave të nenit 29, ligji Nr.8438, datë 28.12.1998 (i ndryshuar).
3. Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë nuk i ka dorëzuar pasqyrat financiare në KQZ për vitin që përfundon më 31.12.2021, sipas kërkesave të nenit 23, ligji Nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike" (i ndryshuar).

ii. Refuzim për të dhënë Opinion

Për shkak të kufizimeve të rëndësishme të përshkruar në paragrafin "Bazat e refuzimit për të dhënë Opinion", nuk na u mundësua marrja e evidencës së auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë. Për këtë arsye, ne nuk mund të shprehim opinion mbi Pasqyrat financiare për fondet e përftuara dhe të shpenzuara nga Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë për vitin raportues që përfundon më 31.12.2021, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar me Ligjin 74/2012), pasi nuk jemi në kushtet e një auditimi ligjor sipas SNA-ve.

Tiranë, më 23 Shtator 2022

Elton Tirana

Auditues Ligjor



Emërtimi dhe Forma ligjore PARTIA POPULLORE KRISTIANDEMOKRATE E SHQIPËRISË
NIPT – i _____
Adresa e selisë Lagja: "Skenderbeg";Rr." Ing.Gjovalin Gjadri",Shkoder
Data e krijimit 18/5/2012
Nr.i Vendimit të Gjykatës 5096 Nr. i Regjistrimit 11691
Veprimtaria Kryesore Parti Politike



PASQYRAT FINANCIARE

Viti 2021

Pasqyra e Financave janë individuale _____ x
Pasqyra e Financave janë të konsoliduara _____
Pasqyra e Financave janë të shprehura në _____ Leke
Pasqyra e Financave janë të rrumbullakosura në lek _____ x

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare Nga 01.01.2021
Deri 31.12.2021
Data e mbylljes së Pasqyrave Financiare 14/3/2022

PARTIA POPULLORE KRISTIANDEMOKRATE E SHQIPËRISË
KRYETARI I BORDIT TË FINANCAVE N/KRYETARI I PARTISË
NIKOLIN SHPATAJ ORJETA SHKAMBI



Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci)


Nr	A K T I V E T	Shënime	2021	2020
	Aktivët afatshkurtra			
	▶ Aktivët monetare			
	1 Banka		0	0
	2 Arka		0	0
	▶ Investime			
	1 Në tituj pronësie të njësisve ekonomike brenda grupit		0	0
	2 Aksionet e veta		0	0
	3 Të tjera financiare		0	0
	▶ Të drejta të arkëtueshme			
	1 Nga aktiviteti i shfrytëzimit		0	0
	2 Nga njësitë ekonomike brenda grupit		0	0
	3 Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		0	0
	4 Të tjera		0	0
	5 Kapital i nënshkruar i papaguar		0	0
	▶ Inventarët			
	1 Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme		0	0
	2 Prodhime në proces dhe gjysmëprodukte		0	0
	3 Produkte të gatshme		0	0
	4 Mallra		0	0
	5 Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje dhe majmëri)		0	0
	6 AAGJM të mbajtura për shitje		0	0
	7 Parapagime për inventar		0	0
	▶ Shpenzime të shtyra			
	▶ Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara			
I	TOTALI I AKTIVEVE AFATSHKURTRA		0	0
	AKTIVET AFATGJATA			
	▶ Aktive financiare			
	1 Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit		0	0
	2 Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit		0	0
	3 Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		0	0
	4 Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		0	0
	5 Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata		0	0
	6 Tituj të tjerë të huadhënies		0	0
	▶ Aktivët materiale			
	1 Toka dhe ndërtesa		0	0

	2 Impiante dhe makineri		0	0
	3 Të tjera instalime dhe paisje		0	0
	4 Parapagime për aktive materiale dhe proces		0	0
	▶ Aktivet biologjike			
	▶ Aktive jo materiale:			
	1 Koncensione,patenta,licenca,marka tregtare, të drejta dhe aktive të ngjashme		0	0
	2 Emri i Mirë		0	0
	3 Parapagime për AAJM		0	0
	▶ Aktive tatimore të shtyra		0	0
	▶ Kapitali i nënshkruar i papaguar		0	0
			0	0
II	TOTALI I AKTIVEVE AFATGJATA		0	0
	AKTIVE TOTALE		0	0

PARTIA POPULLORE KRISTIANDEMOKRATE E SHQIPËRISË


KRYETARI I BORDIT TË FINANCAVE

NIKOLIN SHPATAJ



N/KRYETARI I PARTISË

ORJETA SHKAMBI



Pasyra e Pozicionit Financiar(Bilanci)

Nr	DETYRIMET DHE KAPITALI	Shënime	2021	2020
	▶ Detyrime afatshkurtra		0	0
1	Titujt e huamarrjes		0	0
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë		0	0
3	Arkëtime në avancë për porosi		0	0
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit		0	0
5	Dëftesa të pagueshme		0	0
6	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit		0	0
7	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		0	0
8	Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore		0	0
9	Të pagueshme për detyrimet tatimore		0	0
10	Të tjera të pagueshme/Hua të tjera		0	0
	▶ Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		0	0
	▶ Të ardhura të shtyra		0	0
	▶ Provizione		0	0
	Totali i Detyrimeve Afatshkurtra			
	▶ Detyrime afatgjata:		0	0
1	Titujt e huamarrjes		0	0
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë		0	0
3	Arkëtimet në avancë për porosi		0	0
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit		0	0
5	Dëftesa të pagueshme		0	0
6	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit		0	0
7	Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		0	0
8	Të tjera të pagueshme		0	0
	▶ Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		0	0
	▶ Të ardhura të shtyra			
	▶ Provizione:		0	0
1	Provizione për pensionet		0	0
2	Provizione të tjera		0	0
	▶ Detyrime tatimore të shtyra		0	0
	Totali i Detyrimeve Afatgjata			
	DETYRIMET TOTALE		0	0
	▶ Kapitali dhe Rezervat		0	0
	▶ Kapitali i Nënshkruar		0	0
	▶ Primi i lidhur me kapitalin		0	0
	▶ Rezerva rivlerësimi		0	0

	► Rezerva të tjera		0	0
	1 Rezerva ligjore		0	0
	2 Rezerva statutore		0	0
	3 Rezerva të tjera		0	0
	► Fitimi i pashpërndarë		0	0
	► Fitim / Humbja e Vitit		0	0
	Totali i Kapitalit		0	0
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		0	0



PARTIA POPULLORE KRISTIANDEMOKRATE E SHQIPËRISË

KRYETARI I BORDIT TË FINANCAVE

N/KRYETARI I PARTISË

NIKOLIN SHPATAJ

ORJETA SHKAMBI

FONDET E PËRFITUARA DHE TË SHPENZUARA GJATË VITIT 2021

Nr	Përshkrimi sipas natyrës	2021	2020
1	Fondet e mara	0	0
1.1	Nga fondet publike	0	0
1.2	Nga kuotat e anëtarëve të partisë	0	0
1.3	Donacionet e përfituara në vlerë monetare	0	0
1.4	Donacionet e përfituar në sende dhe shërbime të vlerësuara me vlerë tregu	0	0
1.5	Përfitime nga reklama televizive	0	0
1	Shuma totale e fondeve të fituara	0	0
2	Shpenzime të kryera për vitin 2019	0	0
2.1	Shpenzimet e punonjësve të administratës	0	0
2.1.1	Pagat e punonjësve	0	0
2.1.2	Sigurimet shoqërore shëndetsore	0	0
2.1.3	Udhëtim dhe dieta	0	0
2.2	Marrje salla me qera	0	0
2.3	Spote publicitare	0	0
2.3.1		0	0
2.4	Konzulenca të ndryshme	0	0
2.4.1		0	0
2.4.2		0	0
2.5	Shpenzime telefonike	0	0
2.5.1	- Telekom < Vodafone etj	0	0
2.5.2	- Albtelekom	0	0
2.6	Postera, fletëvolante, fletëpalosje, reklama, banderola	0	0
2.6.1		0	0
2.6.2		0	0
2.7	Shpenzime kancelari	0	0
2.7.1	Kancelari letër		
2.7.2		0	0
2.7.3		0	0

2.7.4		0	0
2.8	SMS Promocionale	0	0
2.9	Karburante		
2.1	Energji elektrike	0	0
2	Totali i shpenzimeve	0	0



PARTIA POPULLORE KRISTIANDEMOKRATE E SHQIPËRISË

KRYETARI I BORDIT TË FINANCAVE

N/KRYETARI I PARTISË

NIKOLIN SHPATAJ

ORJETA SHKAMBI

PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË

Metoda direkte

Për vitin financiar deri me 31 Dhjetor 2021

	2021	2020
Fluksi i parave nga veprimtaria e shfrytëzimit		
Paratë e arkëtuara nga kuotat		
Paratë e donacionet	0	0
Paratë e shpenzuara		
Interesi i paguar		
Tatim fitimi i paguar		
MM neto nga veprimtaria e shfrytëzimit	0	0
Fluksi monetar nga veprimtaria investuese		
Blerja e njësisë së kontrolluar X minus paratë e arkëtuara		
Blerja e aktiviteteve afatgjata materiale		0
Të ardhura nga shitja e paisjeve	0	
Interes i arkëtuar		
Dividentët e arkëtuar		
MM neto të përdorura në veprimtarinë investuese	0	0
Fluksi monetar nga aktivitetet financiare		
Të ardhura nga emetimet e kapitalit aksioner		
Të ardhura nga huamarrje afatgjata		0
Pagesat e detyrimeve të qerasë financiare	0	
Dividentët e paguar		
MM neto të përdorur në veprimtarinë financiare	0	0
Rritja / rënia neto e mjeteve monetare	0	0
Mjete monetare në fillim të periudhës	0	0
Mjete monetare në fund të periudhës kontabile	0	0



PARTIA POPULLORE KRISTIANDEMOKRATE E SHQIPËRISË

KRYETARI I BORDIT TË FINANCAVE

N/KRYETARI I PARTISË

NIKOLIN SHPATAJ

ORJETA SHKAMBI

PASQYRAT FINANCIARE 2021

SHËNIMET PËR PASQYRAT FINANCIARE

Politikat Kontabele


Për hartimin e pasqyrave financiare për periudhë 01.01.2021 – 31.12.2021 është mbështetur në Standartet Kombëtare Të Kontabilitetit për bliancet e OJF. Të ardhurat dhe shpenzimet klasifikohen sipas natyrës dhe pasyra është hartuar sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Mjetet monetare në arkë dhe bankë janë paraqitur me vlerën e drejtë.

Nuk ka llogari bankare.

Gjatë vitit 2020 nuk ka kryer as një arkëtim ose pagesë.

KRYETARI I BORDIT TË FINANCAVE

NIKOLIN SHPATAJ



N/KRYETARI I PARTISË

ORJETA SHKAMBI

